

**UDHËZUES
ARSIMOR PËR
EMIGRANTËT NË
MBRETËRINË E
BASHKUAR**

ALSA UK





PËRMBAJTJA

HYRJE NË SISTEMIN ARSIMOR TË MBRETËRISË SË BASHKUAR (MB)	3
ARSIMI I MESEM	4
ÇERTIFIKATA E PËRGJITHSHME E PROVIMIT TË ARSIMIT TË MESEM (GCSE)	5
MUNDËSITË E ARSIMIT PËR EMIGRANTËT NË MBRETËRINË E BASHKUAR FORMA E GJASHTË PËR EMIGRANTËT E MOSHËS 19+	6
APLIKIMI DHE REGJISTRIMI NË KOLEGJ	8
KUALIFIKIMI PROFESIONAL KOMBËTAR (NVQS)	11
KURSET E ANGLISHTES PËR JOANGLISHTFOLËSIT (ESOL)	13
PRAKTIKA	14
UNIVERSITETI	15
MUNDËSITË E ARSIMIT PËR ATA QË MBAJNË LEJE TË KUFIZUAR PËR TË QËNDRUAR (LIMITED LEAVE TO REMAIN), LEJE DISKRECIONAR PËR TË QËNDRUAR (DISCRETORY LEAVE) OSE LEJE UASC (UASC LEAVE)	16
ÇFARË ËSHTË “PRANIMI KONTEKSTUAL” DHE SI MUND T’JU NDIHMOJË?	18
BURIMET	19
REFERENCAT	20

HYRJE NË SISTEMIN ARSIMOR TË MBRETËRISË SË BASHKUAR (MB)

Në MB ka pesë faza të arsimit: vitet e hershme, shkolla fillore ose ajo primare (mosha 5-11), shkolla sekondare ose ajo e mesme (mosha 11-16), arsimi i mëtejshëm (mosha 16-18) dhe arsimi i lartë (mosha 18-20+). Arsimi është i detyrueshëm për të gjithë fëmijët nga mosha 5 (4 në Irlandën e Veriut) dhe 16 vjeç. Arsimi i metejshem nuk është i detyrueshëm dhe përfshin arsimin jo të avancuar që mund të merret në kolegjet e arsimit të mëtejshëm dhe në institucionet e arsimit te mëtejshëm ([GOV.UK](https://www.gov.uk), 2024).

SISTEMI ARSIMOR NË MBRETËRINË E BASHKUAR I DETYRUESHËM PËR TË GJITHË NXËNËSIT E MOSHAVE 5 - 16 VJEÇ



Në Mbretërinë e Bashkuar, sistemi arsimor është i ndarë në disa kategori, kryesisht në shkolla publike (shtetërore) dhe shkolla private (të pavarura). Shkollat publike në MB janë shkolla të financuara nga shteti dhe ofrojnë arsim falas për të gjithë fëmijët. Këto shkolla financohen nga qeveria dhe duhet t'i përmbahen kurrikulës kombëtare të MB. Shkollat shtetërore frekuentohen nga shumica e fëmijëve në MB. Është e rëndësishme të theksohet se ka lloje të ndryshme të shkollave shtetërore, shkolla të tilla si Grammar Schools ku nxënësit përzgjidhen në bazë të aftësive akademike, zakonisht përmes një provimi pranues të njohur si 11-plus. Nga ana tjetër, shkollat private janë shkolla me pagesë dhe nuk financohen nga qeveria. Këto shkolla mund të zgjedhin në mënyrë të pavarur programin e tyre arsimor, si dhe rregullat e pranimit të nxënësive, për shembull shkollat ditore (day schools) ose shkollat me konvikt (boarding schools).

Pas arsimit dytësor, fëmijët do të duhet të qëndrojnë në një formë arsimimi ose trajnimi derisa të mbushin 18 vjeç. Ka shumë mundësi arsimimi në këtë fazë. Këto opsione përfshijnë Nivelet e Avancuara ose Nivelet A (A Levels), kualifikimi i Këshillit të Arsimit të Biznesit dhe Teknologjisë (BTEC), Kualifikimet Profesionale Kombëtare (NVQ), diploma, praktika dhe më shumë. Faza e pestë, pra arsimi i lartë është studimi përtej



GCSE, niveleve A dhe ekuivalentëve të tyre, dhe për shumicën e studentëve, zhvillohet në universitete, institucione të arsimit të mëtejshëm dhe kolegje të tjera.

Azilkërkuesit, refugjatët dhe nxënësit që janë emigrantë ekonomikë dhe i përkasin moshës 5-18 vjeç kanë të njëjtat të drejta për arsimim ose trajnim full time me kohë të plotë si nxënësit e tjerë në Angli. Ky rregull zbatohet njëjloj për të gjitha shkollat e autoriteteve lokale, akademitë si dhe shkollat falas. Arsimi fillor dhe i mesëm nuk ndikohet nga statusi i emigracionit të fëmijës ose prindit, megjithatë kjo mund të mos jetë njëjtë për sa i përket financave për arsimin e mëtejshëm dhe të lartë ([The Bell Foundation](#), 2024)

ARSIMI FILLOR

Në përgjithësi, të gjithë nxënësit, pavarësisht nga statusi i tyre i emigrimit, kanë të drejtë të studiojnë në shkollat fillore ose primare të Mbretërisë së Bashkuar pasi të kenë mbërritur në MB. Shkolla primare (Primary School) në MB është ekuivalente me shkollën fillore. Fillon rreth moshës 4-5 vjeç dhe vazhdon deri në moshën 11 vjeç ([Immigration UK](#), 2024).

- Shkollës fillore i paraprin arsimi parashkollor (normalisht për fëmijët e moshës nga dy deri në pesë vjeç) dhe pasohet nga shkolla sekondare.
- Arsimi fillor në MB zakonisht ndahet në fazat kryesore të mëposhtme:
 - **Kopështi dhe vitet përgatitore** (3-5 vjeç). Ndryshe të njohura si Faza e themelimit të viteve të hershme (Early Years Foundation Stage, EYFS)
 - **Faza kryesore 1:** Vitet 1 deri në 2 (5-7 vjeç)
 - **Faza kryesore 2:** Vitet 3 deri në 6 (7-11 vjeç)

ARSIMI I MESËM

Në përgjithësi, të gjithë studentët, pavarësisht nga statusi i tyre i emigrimit, kanë të drejtë të studiojnë në shkollat dytësore të Mbretërisë së Bashkuar pasi të kenë mbërritur në MB. Shkolla sekondare (dytësore) për studentët në MB fillon rreth moshës 11/12 vjeç dhe zgjat deri në moshën 18 vjeç. Dy vitet e fundit të arsimit të mesëm zakonisht quhen "Forma e Gjashtë" (Sixth Form) ose Kolegj ([UK Immigration](#), 2024).

- Ashtu si arsimi fillor në MB, shkolla e mesme zakonisht ndahet në fazat kryesore të mëposhtme:
 - **Faza kryesore 4:** Vitet 10 deri në 11 (14-16 vjeç)
 - **Faza kryesore 5:** Më shpesh quhet Kolegji ose Forma e Gjashtë. Kjo mbulon vitet 12 dhe 13 (16-18 vjeç). Lëndët në këtë nivel janë më të përshtatura për arsimimin e mëtejshëm të çdo studenti.



ÇERTIFIKATA E PËRGJITHSHME E PROVIMIT TË ARSIMIT TË MESËM (GCSE)

Studentët e shkollave të mesme/sekondare në Mbretërinë e Bashkuar duhet të marrin pjesë në "Provimet e Përgjithshme të Çertifikatës së Arsimit të Mesëm", të njohura si GCSE (General Certificate of Secondary Education Exams), të cilat janë të detyrueshme edhe për ata që nuk ndjekin studimet universitare më tej. Së paku, studentët duhet të japin provimet GCSE në secilën nga lëndët kryesore (Matematikë, Anglisht, Shkencë). Sidoqoftë, GCSE-të ofrohen në lëndë të shumta dhe shumica e studentëve marrin përafërsisht 9 lëndë GCSE ([UK Immigration, 2024](#)).

Përveç GCSE-ve bazë, studentët që kërkojnë të vazhdojnë studimet universitare marrin pjesë në provimet e niveleve të Avancuara (A levels), në lëndë edhe më të specifikuar që studentët fillojnë t'i studiojnë për dy vjet përpara se të bëjnë provimet përfundimtare. Këto provime, gjegjësisht Nivelet A përfundojnë rreth moshës 17-18 vjeç. Nivelet A bazohen në njohuritë e marra nga programi GCSE ([UK Immigration, 2024](#)). GCSE-të vlerësohen në një shkallë numerike nga 1-9 (9 është rezultati më i lartë); ndërsa A-Nivelet në një shkallë shkronjash U-A (A është më e mira). Vini re se ndërsa, teknikisht nuk kërkohet me ligj që të merren GCSE, kjo kërkohet për pranimin në universitet në Mbretërinë e Bashkuar dhe shumë vende pune do të kërkojnë që aplikantët të japin rezultatet e GCSE, edhe nëse nuk kanë shkuar në universitet ([UK Immigration, 2024](#)). Për ata me kualifikime ndërkombëtare, ju lutemi shihni Faqen 11 për më shumë rreth Niveleve A (A-Levels).

Studentët që vendosin të mos vazhdojnë studimet universitare kanë mundësinë të shkojnë në trajnim profesional.

UNIVERSITETI NË MB

Ata që dëshirojnë të studiojnë në universitetet e Mbretërisë së Bashkuar duhet të dinë se pranimi në universitet në shkollat e MB është një proces me konkurrencë të lartë. Pranimet bazohen në provimet shtetërore të GCSE dhe nivelet A, të cilat shumica e studentëve i marrin në vitet e fundit të shkollës së mesme.

Ata që kërkojnë pranim në universitet në vendet e Mbretërisë së Bashkuar duhet të kenë parasysh se kostoja e shkollimit në universitetet britanike për qytetarët/shtetasit e Mbretërisë së Bashkuar është shumë më e ulët kur krahasohet me atë që duhet të paguajnë studentët që nuk janë shtetas të MB. Për shembull, kostoja e shkollimit në Universitetin e St. Andrews në Skoci për shtetasit skocezë është £1820 në krahasim me



£25,100 për studentët ndërkombëtarë (studentët jo-skocezë në MB paguajnë £ 9,250) ([Immigration UK](#), 2024).

Shumica e universiteteve britanike ofrojnë programe Bachelor që zgjasin 3 vite (kjo është në kontrast me sistemin amerikan, në të cilin studentëve normalisht u duhen 4 vite për t'u diplomuar. Në fund të vitit të tyre në universitet, studentët japin provime në çfarëdo lëndë që marrin, dhe kështu arrijnë deri në diplomim.

MUNDËSITË E ARSIMIT PËR EMIGRANTËT NË MBRETËRINË E BASHKUAR FORMA E GJASHTË PËR EMIGRANTËT E MOSHËS 19+

Forma e gjashtë i referohet pjesës së viteve arsimore të studentëve ku ata studiojnë nivelin A dhe ndonjëherë edhe kualifikimet profesionale, pasi të kenë mbaruar arsimin e tyre formal, pra përfundimi vitit 11.

Nëse keni leje të pacaktuar për të hyrë ose për të qëndruar (Indefinite Leave to Enter or Remain), ju do të trajtoheni njësoj si një shtetas britanik për sa i përket financimit për arsimim. Kjo është e vërtetë sapo të merrni statusin tuaj të refugjatit dhe është e pasaktë që duhet të keni qenë në MB për një periudhë të caktuar kohore ([Refugee Education UK](#), 2024).

Pagesa për Kolegjin ose Formën e Gjashtë

Shumica e kurseve të nivelit të parë të hyrjes, nivelit 1 ose nivelit 2 janë falas pavarësisht nga mosha. Sidoqoftë, mund të duhet të paguani për disa kurse. Ka katër mënyra kryesore për të paguar për një kurs arsimimi të mëtejshëm: financimi nga qeveria, vetë-financimi, skema për fëmijë nën përkujdesje (Looked After Child, LAC) ose mbështetja dhe bursa për individë të larguar nga sistemi kujdestar.

Shumica e individëve kanë të drejtë të punojnë dhe mund të fitojnë para për të paguar studimet e mëtejshme të arsimimit. Shumë kolegje ofrojnë kurse me kohë të pjesshme dhe gjatë orëve të mbrëmjes që ju lejojnë të punoni dhe studioni. Është e rëndësishme të mbani mend se kolegjet e arsimimit të mëtejshëm janë të rrepta dhe kërkojnë një rekord të mirë prezence për diplomim ([Refugee Education UK](#), 2024).

Për personat që janë rritur në shtëpi fëmijësh ose jetimore ose nga dikush jashtë familjes së afërt

Fëmijët nën përkujdesje (Looked After Child, LAC) përkufizohen si ata që janë nën kujdesin e autoritetit të tyre lokal ([SCOT GOV](#), 2024). Një fëmijë që largohet nga kujdesi



është një i ri midis moshës 16-25 vjeç, i cili ka jetuar nën kujdes për të paktën 13 javë që nga ditëlindja e tij e 14-të ([Foster Care UK, 2024](#)).

Nëse jeni një LAC ose një i larguar nga përkujdesi lokal, sigurohuni që ta njoftoni kolegjin sepse mund të keni të drejtë për heqjen e tarifës. Nëse jeni në përkujdesje ose larguar nga kujdesi, mund të aplikoni për një bursë "16-19" për t'ju ndihmuar me çdo kosto që keni bërë gjatë studimit në kolegji. Kjo bursë vlen deri në £ 1200 në vit. Nëse kursi është më i shkurtër se një vit i plotë akademik, bursa do të ofrohet në mënyrë proporcionale.

Nëse jeni larguar nga kujdesi, duhet të flisni edhe me Këshilltarin tuaj Personal për informacion në lidhje me mbështetjen shtesë për të rinjtë në arsim. Këshillat vendore shpesh kanë një rol të rëndësishëm në mbështetjen financiare për të rinjtë që qëndrojnë në arsim dhe trajnim ([REUK, 2024](#)).

SHOQATA BAMIRËSE QË OFROJNË NIDHMË FINANCIARE

Ky mjet kërkimi i granteve i lejon studentët të fusin kodin e tyre postar për të aksesuar informacionin mbi grantet për të cilat mund të aplikojnë: <https://www.turn2us.org.uk/>

- **The Black Heart Scholars Programme** jep disa bursa vjetore kandidatëve për të çuar përpara qëllimet e tyre arsimore dhe aspiratat e jetës, ku përndryshe ata nuk do të ishin në gjendje ta bënin këtë. Programi është i hapur për studentët në faza të ndryshme të arsimimit të tyre.
<http://blackheartfoundation.org/scholarship-programme/>
- **The Prince's Trust** jep grante për të rinjtë e moshës 17-25 vjeç, që punojnë më pak se 16 orë ose janë në arsim për më pak se 14 orë në javë, për të ndihmuar në hyrjen në punë, arsimim ose trajnim. Gjithashtu ofrohen kredi për të ndihmuar të rinjtë të fillojnë një biznes: <https://www.princes-trust.org.uk/how-we-can-help/get-funding-train-learn>
- **Schwab & Westheimer Trust** punon me një numër donatorësh bujarë për të ofruar një sërë bursash për studime universitare dhe pasuniversitare. Këto bursa janë për studentët me një sfond të emigrimit të detyruar të cilët nuk kanë të drejtë për financim studentor për shkak të statusit të tyre të emigrimit
<https://www.swtrust.org.uk/index.html>
- **Fondacioni Helen Kennedy** ofron mbështetje, në formën e një burse zakonisht deri në £2,250, për të ndihmuar me kostot e arsimit të lartë. Ky grant është pjesë



e një pakete më të gjerë mbështetjeje, duke përfshirë mbështetjen personale dhe praktike dhe mundësitë për të mbështetur tranzicionin e të rinjve në dhe përmes arsimit të lartë <https://www.hkf.org.uk/hkf-awards/>

PËR MË SHUMË VIZITONI: <https://www.reuk.org/funding>

APLIKIMI DHE REGJISTRIMI NË KOLEGJ

Nëse po mendoni të aplikoni për të studiuar në kolegji ose në formën e gjashtë, filloni duke vizituar faqen e internetit të kolegjit përkatës. Gjëra të rëndësishme për t'u konsideruar janë:

- 1. Kur fillon kursi?**
- 2. Çfarë kualifikimesh** do t'ju nevojiten për tu pranuar në kurs?
- 3. Sa kohë** zgjat kursi?
- 4. Nëse është e përshtatshme** për ju për sa i përket moshës tuaj.

Mos harroni të shihni nëse kursi për të cilin jeni i interesuar është falas për ju ose nëse do t'ju duhet të vetëfinancoheni. Viti akademik për të gjitha kurset kryesore në arsimin e mëtejshëm dhe kolegjet e formës së gjashtë zgjat nga 31 Gushti deri në javën e parë të Korrikut, në varësi të kolegjit.

Kolegjet e Arsimit të Mëtejshëm mbushin shpejt vendet e tyre në kurset më popullore dhe pasi të marrin mjaftueshëm aplikime, ata mbyllin aplikacionet në faqen e tyre të internetit për atë vit. Pra, ju duhet të dorëzoni aplikacionin tuaj online sa më shpejt të jetë e mundur. Shumica e kolegjeve fillojnë të pranojnë aplikime nga Janari për kurset që fillojnë në Gusht të atij viti ([REUK, 2024](#)).

Dita e regjistrimit është dita juaj e parë në kolegji. Në këtë ditë, stafi i kolegjit do të vlerësojë rrethanat tuaja, do të shoh nëse i përmbushni kërkesat minimale akademike dhe joakademike dhe do t'ju regjistrojë zyrtarisht si student. Disa kolegje do t'ju japin gjithashtu ID-në tuaj studentore në këtë ditë. Për azilkërkuesit dhe refugjatët, kërkoni të flisni me koordinatoren e pjesëmarrjes në zgjerim ose koordinatoren e fondit të vështirësive për të mësuar më shumë rreth mbështetjes financiare dhe bursave në dispozicion për të përmbushur nevojat tuaja arsimore.

Dokumentet e nevojshme për regjistrim

Dëshmia e rezidencës

Për azilkërkuesit dhe refugjatët, kjo do të ishte Karta juaj e Regjistrimit të Aplikimit për Azil (Application Registration Card, ARC) ose Leja Biometrike e Qëndrimit (Biometric



Residency Permit, BRP). Nëse nuk keni kartën tuaj ARC ose BRP, merrni letrën tuaj BAIL 201 nga Home Office së bashku me një letër nga avokati juaj për të dëshmuar identitetin tuaj. Letra nga avokati juaj duhet të ketë të bashkangjitur fotografinë tuaj të madhësisë së fotografisë së pasaportës ([REUK, 2024](#)).

Nëse ekipi i regjistrimit të kolegjit refuzon dokumentet e mësipërme, duhet të konsideroni aplikimin dhe regjistrimin në një kolegji tjetër. Nëse nuk keni një kartë ARC, por keni një formë tjetër identifikimi fotografik - d.m.th. një leje drejtimi provizore ose të plotë - kjo mund të pranohet së bashku me dokumentet tuaja nga Home Office që vërtetojnë se kërkesa e ardhshme për azil studentor është në proces - e datuar 6 muaj më parë ([REUK, 2024](#)).

Për ata që kanë viza të lejes së hyrjes në pasaportën e tyre p.sh. ato me viza për bashkim familjar ose risistemim, vizat tuaja do të merren parasysh ([REUK, 2024](#)).

SI TË ZGJEDH NJË KURS ARSIMIMI TË MËTEJSHËM? KURSET NË TË CILAT MUND TË KENI QASJE OSE KURSET HYRËSE

Kursi i Diplomës së Aksesit në Arsimin e Lartë është një kualifikim i Nivelit 3, pra është i barabartë me Nivelet A. Ai është krijuar për të përgatitur individë, 19 vjeç e lart, të cilët nuk kanë ende kualifikimet e nevojshme për të hyrë në universitet ose në institucione të tjera të arsimit të lartë. Nëse jeni mbi 19 vjeç, keni mbaruar shkollën e mesme në vendin tuaj dhe keni një nivel të mirë të gjuhës angleze të shkruar, atëherë një kurs aksesit mund të jetë i duhuri për ju. Kursi u drejtohet njerëzve që kanë qenë jashtë arsimit për disa kohë, ose që kanë pasur ndërprerje në arsimin e tyre, ose që nuk kanë pasur mundësi të marrin nivelet A për të aplikuar në universitet ([North Somerset Council, 2024](#)).

Shumica e kolegjeve të Arsimit të Mëtejshëm japin kurse aksesit me kohë të plotë (full time) dhe me kohë të pjesshme (part time). Disa i lejojnë studentët të ndjekin GCSE në gjuhën angleze dhe matematikë së bashku me kursin e aksesit. Kur të keni përfunduar kursin, do t'ju jepet “Diploma e Qasjes në Arsim të Lartë” (Access to HE Diploma).

Kurset e Aksesit ofrohen në disa lëndë, për shembull, Infermieri dhe Mjekësi, Biznes, Studime Sociale, Drejtësi dhe Art dhe Dizajn dhe është i barabartë me tre nivele A. Këto kurse ofrohen nga shumë kolegje të arsimit të mëtejshëm në MB dhe njihen nga shumë universitete. Aksesit në tarifën e shkollimit të kurseve të Arsimit të Mëtejshëm ndryshojnë midis kolegjeve dhe ndryshojnë çdo vit.



Në varësi të moshës tuaj dhe statusit të emigrimit, ju mund të keni të drejtë për financim. Është e rëndësishme që të kontaktoni kolegjin ku dëshironi të studioni për të mësuar rreth tarifave të kursit dhe se si ato aplikohen për ju.

Nëse jeni mbi ose 19 vjeç dhe keni formë të caktuara të statusit të emigracionit, si status refugjati dhe mbrojtje humanitare, ju mund të aplikoni për një *Hua të Avancuar për Nxënësit 19+* ([Advanced Learner Loan](#)) për të ndihmuar në pagesën e kursit tuaj. Kredia është e ripagueshme vetëm pasi të punësoheni dhe të fitoni mbi £ 26,575 në vit. Për më tepër, nëse përfundoni një diplomë të Arsimit të Lartë pas kursit tuaj të Nivelit 3, nuk keni detyrim të paguani kredinë tuaj të avancuar ([REUK, 2024](#)).

Nëse nuk keni të drejtë për një kredi të avancuar për nxënës, mund të aplikoni për bursa për të ndihmuar në financimin e arsimit tuaj. [Këtu është një listë e ofruesve të granteve arsimore](#) ku mund të aplikoni. Jo të gjitha sugjerimet në këtë listë do të jenë të përshtatshme për të gjithë, prandaj sigurohuni që të shikoni kriteret për shoqatat e ndryshme (d.m.th. disa mund të financojnë vetëm njerëz të moshave të veçanta, feve të veçanta, që studiojnë lëndë të veçanta, me status të veçantë emigrimi etj).

Kurset e aksesit ofrohen nga kolegjet në të gjithë Mbretërinë e Bashkuar.

DIPLOMAT BTEC

BTEC (Business and Technology Education Council) janë kualifikime profesionale që janë krijuar për t'ju përgatitur për punë. Ato janë të disponueshme nga niveli i hyrjes në nivelin 7 (pasuniversitar) ([REUK, 2024](#)).

BTEC ka tre niveleve kryesore të studimit:

1. **BTEC Firsts** janë nga Niveli Fillestar në Nivelin 2, këto do t'ju njohin me punën në sektorin profesional. Kombinuar me kualifikime të tjera si GCSE, ato mund t'ju ndihmojnë të përparoni në një nivel të mëtejshëm ose drejtpërdrejt të punësoheni.
2. **BTEC Nationals** janë nga Niveli 3 e lart, këto konsiderohen të barazvlefshme me nivelet A dhe pranohen nga universitetet dhe punëdhënësit. BTEC Nationals mund t'ju çojnë të fitoni një vend në universitet, duke vazhduar studimet dhe punësimin e drejtpërdrejtë. Kur aplikoni në universitete, është e rëndësishme të kontrolloni nëse kualifikimet BTEC pranohen për degën ku po aplikoni.
3. **BTEC Apprenticeships** është Praktikë e disponueshme nga Niveli 2 në Nivelin 5



A mund të kryhet një program BTEC krahas kualifikimeve tradicionale akademike?

Po, ju mund të studioni BTEC vetëm, ose në nivelin 2/3 së bashku me kualifikimet akademike si GCSE ose edhe një program më të gjerë me praktikë. Kjo do të ndryshojë nga kolegji në kolegji, kështu që ju këshillojmë të kërkonti udhëzime nga administratorët e kolegjit) ([REUK](#), 2024).

Shembuj të kualifikimeve të BTEC përfshijnë: shkencën e aplikuar, kujdesin shëndetësor dhe social, teknologjinë e informimit dhe komunikimit, sportin, kujdesin për fëmijët, artin dhe dizajnin, biznesin, inxhinierinë, inxhinierinë e ndërtimit, media etj.

KUALIFIKIMI PROFESIONAL KOMBËTAR (NVQS)


NVQ-të janë kualifikime profesionale që bazohen tërësisht në detyra praktike të lidhura me punën. Ju duhet të jeni mbi 16 vjeç dhe të keni të drejtë të punoni për të hyrë në NVQ. Këto janë krijuar për të testuar aftësitë tuaja në një vend pune të caktuar. Zakonisht do të trajnoheni për një periudhë të caktuar dhe pas përfundimit, do të vlerësoheni për të vërtetuar se mund të kryeni disa detyra të lidhura me punën.

NVQ-të janë të disponueshme në shumë lëndë, duke filluar nga kujdesi për fëmijët deri tek hidrauliku. Ata janë zakonisht një zgjedhje e mirë nëse e dini dhe kuptoni se çfarë pune do të dëshironit të bënit. Nuk ka kufi moshe apo kërkesa të veçanta për të studiuar në nivelin NVQ, megjithatë, për të filluar një nivel më të lartë, duhet të keni përfunduar atë të mëparshmin, për shembull, të përfundoni një NVQ të Nivelit 2 përpara se të filloni atë të Nivelit 3 ([REUK](#), 2024).

NVQ-të janë të ndërtuara **në pesë nivele**, normalisht do të vlerësoheni në atë mënyrë që të mund të filloni një nivel që ju përshtatet dhe më pas të shkoni në një nivel më të lartë. Ato mund të merren nga punonjësit me kohë të plotë ose me kohë të pjeshme në një shkollë, kolegji ose vende pune që janë të pajisura për t'u mundësuar punonjësve të zhvillojnë aftësitë e duhura.

NVQ-të nuk kanë një kohë specifike të përfundimit, kjo zakonisht do të varet nga ofruesi i trajnimit, por shumicës se nxënësve ju duhet rreth një vit për të përfunduar një NVQ të Nivelit 1, 2 ose 3.

Nivelet Kombëtare të Kualifikimit Profesional (NVQ)



NIVELET E AVANCUARA (A Levels)

Nivelet e avancuara ose nivelet A janë kualifikimi kryesor për shkollat dhe kolegjet e formës së gjashtë në MB. Këto nivele njihen profesionalisht si GCE Advanced Level. Ndryshe nga GCSE, nivelet A nuk janë të detyrueshme, ato zakonisht përbëhen nga tre ose më shumë lëndë dhe studiohen për një periudhë prej dy vitesh. A-Levels mund t'ju çojnë drejtpërdrejt në universitet, punë ose studime të mëtejshme. Nivelet A janë shumë akademike, kështu që ndryshe nga BTEC ose NVQ, ka pak aplikim praktik dhe nuk ka përvojë të bazuar në punë (REUK, 2024).

Do t'ju kërkohet të keni të paktën pesë GCSE me nota 9 deri në 4 (më parë A* - C) dhe të paktën një notë B në lëndën specifike që keni ndërmend të studioni. Kërkesat specifike të nevojshme për të studiuar Nivelet A ndryshojnë në kolegje, kështu që është e rëndësishme që të kontrolloni se çfarë ju nevojitet me kolegjin ku doni të studioni (REUK, 2024).

Zakonisht, do t'ju duhen të paktën katër GCSE për t'u kualifikuar për të studiuar nivelet A, me disa kurse që kërkojnë që të keni nota të caktuara në lëndët përkatëse. Nëse jeni mbi moshën 18 vjeç dhe dëshironi të merrni nivelet A, duhet t'i organizoni vetë studimet tuaja, ose duke kontaktuar drejtpërdrejt kolegjet, ose duke përdorur një ofrues online. Organizimi i niveleve A për të rriturit në MB është një proces i drejtpërdrejtë. Kurset online janë një mundësi e shkëlqyer për ata që punojnë në të njëjtën kohë ([CoursesOnline](#), 2024).

Dua të shkoj në universitet, a mund të përdor kualifikimet nga vendi im për t'u regjistruar drejtpërdrejt në nivelet A pa GCSE?



Nëse keni përfunduar arsimin e mesëm (Gjimnaz, Shkollë e Mesme) në Shqipëri, Kosovë ose Maqedoninë e Veriut dhe keni kaluar me sukses provimet përfundimtare (Provimi I Matures ose Provimi Lirimi), atëherë keni të drejtë të aplikoni drejtpërdrejt në Universitet në Mbretërinë e Bashkuar, pa pasur nevojë për nivelet A. Diploma dhe/ose transkriptet tuaja do të duhet të konvertohen nga NARIC (kini parasysh se gjithashtu mund të ketë nevojë të përkthehen nga një përkthyes i çertifikuar). Duhet gjithashtu të keni parasysh se mund të jetë e nevojshme të bëni një test të gjuhës Angleze, si TOEFL ose IELTS. Megjithatë, ju sugjerojmë që ta konsideroni këtë më në detaje dhe të konsultoheni me një mësues ose dikë që punon në arsim. Vini re se kjo vlen për ata që veç se janë në MB me status emigranti. Nëse doni të aplikoni nga Shqipëria, Kosova ose Maqedonia e Veriut mund ti referoheni [Doracakut tonë për Studentët Ndërkombëtar](#).

KURSET E ANGLISHTES PËR FOLËSIT E GJUHËVE TË TJERA (ESOL)

Kurset ESOL janë për studentët, gjuha e parë e të cilëve nuk është anglishtja dhe duan të përmirësojnë aftësitë e tyre në gjuhën angleze.

Kursi ndahet në katër pjesë: të folurit dhe të dëgjuarit, të lexuarit dhe të shkruarit dhe një student duhet të kalojë secilën pjesë për të përparuar në nivelin tjetër. Kursi jo vetëm që përmirëson anglishten dhe njohuritë gjuhësore, por edhe ju prezanton me punësimin, kulturën dhe shtetësinë britanike. Nëse flisni fare pak, ose nuk flisni dot anglisht, ky është kursi për ju. Do të jeni në gjendje të mësoni anglisht pavarësisht nivelit tuaj fillestar. Disa kurse të Nivelit 1 dhe të Nivelit 2 si Kontabilitetit dhe Biznesit mund të studiohen krahas kurseve ESOL për t'ju ndihmuar të zhvilloni aftësitë tuaja profesionale duke përdorur anglishten si gjuhë të dytë.


Për nxënësit 16-18 vjeç

Në këtë grupmoshë, të rinjtë e pashoqëruar azilkërkues (Unaccompanied Asylum Seeking Children, UASC) që sapo kanë mbërritur në MB inkurajohen veçanërisht të regjistrohen. Kursi zgjat zakonisht një vit ku nxënësit studiojnë për 16 orë në javë. Klasat zhvillohen në baza ditore dhe në mbrëmje me mbështetjen e një mësuesi personal, ku përfshihen seminare dhe udhëtime gjatë vitit.

Për të rriturit (19 dhe më lart)

Kursi ESOL do t'ju ndihmojë të rrisni pavarësinë tuaj, të keni akses në nivele më të larta të arsimit të mëtejshëm dhe të përmirësoni mundësitë për punë. Klasat ESOL për nxënës të rritur zakonisht zhvillohen për 1 vit dhe mund të mbahen me kohë të pjesshme (2 ditë në javë). Kursi mund t'ju ndihmojë nëse nuk mund të lexoni ose shkruani në anglisht, të mësoni se si të përdorni kompjuterë për të mësuar dhe të merrni një kualifikim dhe certifikatë të gjuhës angleze të njohur në nivel kombëtar.

Kurset janë të disponueshme për t'iu përshtatur të gjithëve, dhe niveli i tyre aktual i anglishtes fillon nga fillestarët në më të avancuarit. Grafiku i mëposhtëm ju tregon se si përparoni nga një nivel në tjetrin, duke filluar nga kurset e parahyrjes ([ESOL Courses](#), 2024). Në fund të çdo niveli, ju do të keni një provim që përfshin të folurit dhe të dëgjuarit, lexim dhe shkrim. Nëse kaloni, mund të përparoni në nivelin tjetër. Kurset ESOL jo vetëm që ndihmojnë në përmirësimin e njohurive të gjuhës angleze, por gjithashtu u mundësojnë individëve të kuptojnë kulturën dhe shtetësinë britanike. Disa kurse do të fokusohen në punësueshmërinë dhe tregun e punës në MB, dhe kjo është veçanërisht e dobishme për ata që kërkojnë të hyjnë në punë ([REUK](#), 2024).



PRAKTIKA

Një praktikë ose stazh praktik është si të kesh një punë, por me kohë që të jepet për të studiuar. Ju do të kaloni afërsisht 80% të kohës tuaj duke punuar dhe 20% të kohës tuaj në kolegji, pra duke mësuar. Duhet të jeni mbi moshën 16 vjeç dhe të keni të drejtë të punoni për të hyrë në praktikë.

Praktikat do t'ju ndihmojnë të përgatiteni për punësim ndërsa fitoni përvojë pune. Në mënyrë të ngjashme me kualifikimet e tjera arsimore, ju mund të përparoni duke ecur përpara përmes niveleve të ndryshme të praktikës deri në arritjen e një diplome master në lëminë tuaj të interesit ([REUK](#), 2024).

Vendet e lira të praktikës gjithmonë specifikojnë kërkesat e hyrjes dhe atë që punëdhënësi kërkon. Normalisht, punëdhënësit do të kërkojnë të paktën një kualifikim të Nivelit 2 dhe disa kërkojnë nivele A ose kualifikime të tjera ekuivalente të Nivelit 3. Është e rëndësishme që të kontrolloni përshkrimin e punës dhe specifikimet personale për çdo aftësi thelbësore dhe të dëshirueshme që mund të kërkohet.

- **Intermediate / e mesme (Niveli 2)** - Aplikantët duhet të jenë të moshës 16 vjeç e lart dhe dëshmi që ata mund të kryejnë nivelin.



- **Advanced / e Avancuar (Niveli 3)** - Disa industri mund të kërkojnë tre ose më shumë GCSE dhe përvojë të mëparshme në industri.

UNIVERSITETI

Nëse keni leje të pacaktuar për të qëndruar (Indefinite Leave to Remain), mund të hyni në universitet. Sidoqoftë, do të paguani harxhimet e shkollimit me një tarifë “ndërkombëtare / jashtë shtetit” nëse keni qenë “banori zakonshëm” në MB për 3 vjet përpara (dhe në) ditën e parë të vitit të parë të kursit. Pas kësaj, ju do të jeni në gjendje të hyni në universitet si student shtetas, ose student shtëpie ([REUK, 2024](#)).

Në mënyrë të ngjashme, për t'u kualifikuar për financimin e studentëve ju duhet të keni qenë “banor i zakonshëm / ordinarily resident” në MB për 3 vjet përpara ditës së parë të vitit të parë të studimeve. Përveç rasteve kur po aplikoni në Skoci ku nuk është e nevojshme të keni qenë “banor i zakonshëm” për 3 vjet, por duhet të jeni banor i zakonshëm në Skoci në ditën e parë të vitit të parë akademik të kursit ([REUK, 2024](#)).

1. Financat studentore

Nëse keni ndonjë nga statutet e mësipërme, zakonisht do të jeni në gjendje të aplikoni për financimin e studentëve nga qeveria për t'ju ndihmuar të paguani tarifën e shkollimit në universitet dhe kostot e jetesës gjatë studimeve. Mos harroni se kjo është një kredi dhe duhet të shlyhet sapo të filloni të fitoni një pagë prej £ 25,000 në vit. Për studentët, ekzistojnë dy kredi kryesore për të cilat mund të aplikoni:

- **Kredia për tarifën e shkollimit:** Kjo është një kredi jo e testuar dhe paguhet drejtpërdrejt në universitet për të mbuluar kostot e tarifës suaj, kjo nuk varet nga të ardhurat e familjes suaj.
- **Kredi për mirëmbajtje:** Kjo është një kredi e testuar (varet nga të ardhurat e familjes) dhe është për të ndihmuar në mbulimin e shpenzimeve tuaja të jetesës, p.sh. qiranë, ushqimin, transportin etj. Shuma që merrni ndryshon në varësi të vendit ku jetoni dhe nëse jetoni me familjen. Ekziston edhe financimi i studentëve për studime pasuniversitare.

2. Vetëfinancimi

Shpesh ata me status më të vendosur kanë të drejtë të punojnë dhe mund të vetëfinancojnë studimet e tyre universitare. Në rast se keni nevojë të përdorni kursimet tuaja personale për të paguar tarifën tuaj të shkollimit mund të konsideroni balancimin e punës me studimin. Shumë degë studimore mund të ndërmerren me punë të pjesshme (part time), si për shembull nëpërmjet mësimin në distancë. Ju lutemi vizitoni këtë [udhëzues nga UCAS](#) për më shumë informacion.

3. Bursat

Nëse keni statusin ILR, por nuk i plotësoni kriteret e banorit të zakonshëm trevjeçar,



disa universitete ofrojnë bursa për njerëzit me sfond refugjatësh dhe azilkërkuesish. Ju lutemi vizitoni faqen e internetit të [Student Action for Refugees \(STAR\)](#) për një listë më të plotë. Gjithashtu mund të vizitoni faqet e financimit të universiteteve të ndryshme për të mësuar më shumë rreth asaj që mund të ofrojnë.

4. Mbështetja për të larguarit nga kujdesi

Nëse jeni/keni qenë i larguar nga kujdesi lokal, mund të keni të drejtë të merrni një grant ose subvencion deri në £ 2,000 nga autoriteti juaj lokal për studimet tuaja universitare. Universiteti gjithashtu mund të ofroj fonde specifike.

MUNDËSITË E ARSIMIT PËR ATA QË MBAJNË LEJE TË KUFIZUAR PËR TË QËNDRUAR (LIMITED LEAVE TO REMAIN), LEJE DISKRECIONAR PËR TË QËNDRUAR (DISCRETORY LEAVE) OSE LEJE UASC (UASC LEAVE)

Me cilindo nga llojet e statusit të listuar më sipër, ju lejohet të shkoni në universitet. Me gjasë do t'ju ngarkohen tarifat e shkollimit me një tarifë “ndërkombëtare / jashtë shtetit” dhe nuk do të keni të drejtë për financimin e studentëve (kreditë nga qeveria për të cilat mund të aplikojnë studentët e tjerë, shtetas të MB). Sidoqoftë, nëse keni banuar në MB për një periudhë të gjatë kohore, mund të kualifikoheni për statusin e tarifës për shtetas (Home Fee) si dhe për financimin e shkollimit për shkak të qëndrimit të gjatë ([REUK](#), 2024).

Për t'u kualifikuar për financimin e studentëve nën kategorinë e qëndrimit të gjatë, duhet të jeni banor në Angli në ditën e parë të vitit të parë akademik të studimeve tuaja, të keni një nga llojet e statusit të mësipërm dhe të keni qenë banor të zakonshëm në MB dhe në ishujt gjatë gjithë periudhës trevjeçare menjëherë përpara ditës së parë të vitit të parë akademik të studimeve tuaj. Ju gjithashtu mund të përfitoni:

- Nëse jeni nën 18 vjeç që keni jetuar në MB për të paktën 7 vjet para ditës së parë të vitit të parë akademik të kursit tuaj;
- ose mbi 18 vjeç dhe keni kaluar të paktën gjysmën e jetës tuaj në MB;
- të keni kaluar të paktën 20 vjet në MB përpara ditës së parë të vitit të parë akademik të kursit tuaj.

Sa i përket rregulloreve të tarifave mund të vizitoni faqen e internetit të Këshillit të MB për Çështjet e Studentëve Ndërkombëtarë - [UKCISA](#).

Nëse ju është dhënë ndonjë nga llojet e statusit të mësipërm dhe keni qenë banor i zakonshëm në MB për 3 vjet, ka të ngjarë të paguani tarifat e shkollimit me tarifën



“shtëpiake”, me një kosto deri në £ 9,250 për vit akademik. Kjo kosto mund të ndryshojë në varësi të universitetit dhe degës së zgjedhur pasi disa tarifa janë pak më të ulëta. Kostot e jetesës mund të ndryshojnë.

Megjithatë, nëse ju është dhënë ndonjë nga llojet e statusit të mësipërm, por nuk keni qenë “banor i zakonshëm” në MB për tre vjet, ju do të paguani tarifat e shkollimit me një tarifë “ndërkombëtare / jashtë shtetit”. Këto kosto mund të ndryshojnë në varësi të universitetit dhe degës së zgjedhur, dhe disa tarifa janë dukshëm më të larta.

Nëse keni një nga llojet e statusit të listuar më sipër, atëherë ka të ngjarë që nuk do të keni mundësi të përfitoni apo të keni qasje në financat e studentëve, përveçse në rastin kur plotësoni kategorinë e qëndrimit afatgjatë për statusin e tarifës shtëpiake (Home Fee). Në këtë rast, do t'ju duhet të organizoni një mënyrë tjetër për të paguar harxhimet universitare.

1. Bursat Universitare

Shumë Universitete ofrojnë bursa për ata që nuk mund të kenë qasje në financat e studentëve për shkak të statusit të tyre të emigracionit. Të gjitha këto kanë emra të ndryshëm, por zakonisht quhen “Sanctuary Scholarships”, “Equal Access” ose “Article 26 Awards”. Këto zakonisht paguajnë tarifat tuaja të shkollimit dhe shpesh ofrojnë fonde shtesë për kostot e jetesës. Për listat e përditësuara se cilat universitete ofrojnë bursa, ju lutemi vizitoni faqen e internetit të [Student Action for Refugees \(STAR\)](#) dhe faqen e internetit të [Article 26](#). Edhe pse shumë prej tyre janë për diploma universitare, disa janë edhe për studime pasuniversitare.

2. Bursat Private

Ekziston një numër i vogël i bursave private në dispozicion për ata që nuk mund të marrin fonde të tjera për studimet e tyre. Këto përfshijnë bursat “[Grenfell](#)”, “[Westheimer](#)” dhe bursat e “[Marks Family Charitable Foundation](#)”.

Nuk ka nevojë të studioni A Levels për të shkuar në universitet. Për t'u pranuar në një kurs universitar, zakonisht do t'ju duhet një nga kualifikimet e mëposhtme të nivelit 3:

- **A Nivelet, ose ekuivalente të huaja (Matura Shtetërore, Provim i Lirimit)**
- **Çmime, certifikata dhe diploma BTEC në Nivelin 3**
- **Baccalaureate Ndërkombëtar (International Baccalaureate)**
- **NVQ në Nivelin 3**
- **Kurset e Aksesit (Access Courses)**



Universitetet mund t'ju kërkojnë të keni një notë kaluese (zakonisht 4 ose C) në Gjuhën Angleze GCSE ose të bëni një test alternativ të gjuhës angleze (siç është [IELTS](#) ose [TOEFL](#)) dhe të arrini rezultatin minimal të kërkuar nga universiteti ([REUK](#), 2024).

UNË KAM ÇERTIFIKATA / DIPLOMA NËPËR GARA NGA VENDI IM, A MUND TË APLIKOJ NË UNIVERSITET DUKE I PËRDORUR ATO?

Agjencia kombëtare për kualifikimet dhe aftësitë ndërkombëtare (UK ENIC) është qendra kombëtare e informacionit që njih dhe vlerëson kualifikimet dhe aftësitë ndërkombëtare. UK ENIC ofron Deklaratë të Krahasueshmërisë, e cila krahason kualifikimet jashtë shtetit me sistemin arsimor të Mbretërisë së Bashkuar. Ky shërbim nuk jep komente për notat, krahasimet e notave ose lëndët e studiuara ([ENIC](#), 2024).

UK ENIC ofron “Deklarata të Krahasueshmërisë” për njerëzit që kanë kualifikime ndërkombëtare dhe duan të studiojnë në MB. Ju mund të aplikoni për këtë [përmes faqes së tyre të internetit](#), por vini re se ka një kosto. Përmes faqes së [REUK](#), mund të shihni se cilat dokumente janë të nevojshme për aplikim në universitet.

ÇFARË ËSHTË “PRANIMI KONTEKSTUAL” DHE SI MUND T’JU NDIHMOJË?

"Pranimi kontekstual" ndodh atëherë kur një universitet konsideron pengesat ose sfidat me të cilën mund të jeni përballur gjatë arsimimit tuaj. Për shkak të kësaj, universiteti mund të zvogëlojë kërkesat e tyre të notave ose të japë konsideratë shtesë kur vendosin nëse do t'ju japin një ofertë për të vazhduar studimet ([REUK](#), 2024).



BURIMET

Nëse po konsideroni të filloni udhëtimin tuaj si student në MB, ose po ndihmoni fëmijët tuaj të fillojnë shkollën në MB, mund të jetë i dobishmëm referimi në faqet në vijim:

Refugee Education UK: <https://www.reuk.org/>

UK Immigration: <https://ukimmigration.co.uk/>

UCAS: <https://www.ucas.com/>

Refugee Study UK: <https://www.refugee-study.co.uk/>

Hope for The Young: <https://hopeforyoung.org.uk/grants-and-advocacy/>

Student Action for Refugees: <https://star-network.org.uk/>

Ruth Hayman Trust: <https://www.ruthhaymantrust.org.uk/>

Refugee Council: <https://www.refugeecouncil.org.uk/>

Study in the UK: <https://www.studying-in-uk.org/>

National Union of Students: <https://www.nus.org.uk/>



REFERENCAT

Courses Online. (2024). *Taking A-Levels as an adult*. [Retrieved April 2024] From: <https://www.coursesonline.co.uk/how-to-take-a-levels-as-an-adult/>

ENIC (2024). *The UK national agency for international qualifications and skills*. [Retrieved April 2024] From: <https://www.enic.org.uk/Qualifications/SOC/Default.aspx>

ESOL Courses. (2024). *ESOL courses*. [Retrieved April 2024] From: <https://www.esolcourses.com/>

Foster Care UK. (2024). *What's a care leaver?* From: <https://www.fostercareuk.co.uk/knowledge-centre/what-is-a-care-leaver>.

GOV SCOT. (2024). *Looked After Children*. [Retrieved April 2024] From: <https://www.gov.scot/policies/looked-after-children/>

GOV UK. (2024). *The Educational System In the United Kingdom*. [Retrieved April 2024] From: https://assets.publishing.service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/219167/v01-2012ukes.pdf

North Somerset Council (2022). *A guide to studying in the UK for refugees and asylum seekers*. [Retrieved April 2024] From: <https://n-somerset.gov.uk/sites/default/files/2023-11/A%20guide%20to%20studying%20in%20the%20UK%20for%20asylum%20seekers%20and%20refugees%20-%20English%20%281%29.pdf>

Refugee Education UK. (2024). *Applying and Enrolling at College*. [Retrieved April 2024] From: <https://www.reuk.org/fefaq-enrol>

Refugee Education UK. (2024). *I have Indefinite Leave to Remain (ILR): what are my options for higher education*. [Retrieved April 2024] From: <https://www.reuk.org/hefaq-ilor>



Refugee Education UK. (2024). *I have LLR, DLR or UASC leave: what are my options for higher education (HE)?* [Retrieved April 2024]

From: <https://www.reuk.org/hefaq-llr-dlr-uasc>

Refugee Education UK. (2024). *Higher Education for Asylum Seekers and Refugees.*

[Retrieved April 2024] From: <https://www.reuk.org/hefaq>

Refugee Education UK. (2024). *How do I choose a further education Course?* [Retrieved April 2024] From: <https://www.reuk.org/fefaq-courses>

Refugee Education UK. (2024). *Options for further education for refugees.* From:

<https://www.reuk.org/fefaq-refuge>

Refugee Education UK, (2024). *What qualifications and documents do I need for university?* [Retrieved April 2024] From:

<https://www.reuk.org/hefaq-qualifications>

The Bell Foundation. (2024). *Rights and entitlements of asylum seekers and refugees in England.* [Retrieved April 2024] From:

<https://www.bell-foundation.org.uk/eal-programme/guidance/schools-and-leaders/refugees-and-asylum-seekers/>

UK Immigration. (2024). *Education in the UK.* [Retrieved April 2024] From:

<https://ukimmigration.co.uk/features/education-in-the-uk/>

Ky doracak është përmbledhur dhe krijuar nga vullnetarët e ALSA-s, me qëllimin më të mirë. Ne nuk ju garantojmë se i gjithë informacioni është krejtësisht i saktë ose i përditësuar. Para se të mirrni vendime ju lutemi të shihni linqet dhe referencat në fund të dokumentit, dhe të këshilloheni me ekspertë. Nëse keni ndonjë pyetje, na kontaktoni në info@alsauk.co.uk

With thanks to Riljeta for putting together this document